



# Vlerësimi përmbledhës i nxënësve: Hartimi i testit

## *Qëllimi i programit:*

Programi “Vlerësimi përmbledhës i nxënësve :Hartimi i testit” është zhvilluar nga Shoqata Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), në kuadër të projektit “Ndërtimi i Kapacitetit në Sektorin e Arsimit Bazik në Kosovë (CDBE) dhe është rishikuar nga Fakulteti i Edukimit/IHZHA me qëllim të ofrimit të këtij programi duke synuar zhvillimin e shkathtësisë të mësimitdhënësve për të zbatuar vlerësimin përmbledhës. Fokus i vecantë i është dhënë aftësive për përpilimin e testeve të cilat përmbushin parimet e vlerësimit të drejtë bazuar në KKK.

## *Grupi i synuar i mësimitdhënësve /vijuesve:*

Ky program i dedikohet mësimitdhënësve të klasave 1-12 të të gjitha fushave, gjithashtu edhe studentëve, të cilët janë duke u përgatitur si mësimitdhënës të ardhshëm. Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim është 15-25.

## *Rezultatet e programit:*

Me përvetësimin e këtij programi, pjesëmarrësit mund të:

- Definojnë vlerësimin përmbledhës dhe rolin e tij;
- Dallojnë elementet themelore, llojet dhe format e vlerësimit përmbledhës;
- Krahasojnë vlerësimin përmbledhës me vlerësimin formues;
- Përdorin procedurat standarde të hartimit të një testi për vlerësim përmbledhës;
- Hartojnë teste vlerësuese duke dalluar nivelet sipas Taksonomisë së rishikuar të Blumit;
- Ndërtojnë strukturën e testit - tabelën e specifikimeve të testit;
- Shkruajnë lloje të ndryshme të pyetjeve sipas rregullave të përcaktuara;
- Realizojnë, për të njëjtën kërkesë/pyetje, kalimin nga një nivel taksonomie në një tjetër;
- Matin treguesit kryesorë të pyetjeve në përbërje të një testi përmbledhës;
- Bëjnë lidhjen ndërmjet rezultateve mësimore me kompetencat e përcaktuara për shkallë të kurrikulës dhe përcaktojnë metodën e vlerësimit;
- Planifikojnë vlerësimin përmbledhës bazuar në RNF dhe RNL të ndërlidhura me kompetencat sipas KK;
- Realizojnë një vlerësim të drejtë, të saktë dhe të besueshëm, transparent dhe të paanshëm;
- Zbatojnë vlerësimin përmbledhës si mjet për motivimin e nxënësve për të arritur kompetencat e synuara;
- Përdorin rezultatet e vlerësimit për të marrë vendime për nxënësit, metodologjinë e mësimitdhënies dhe kurrikulën;
- Raportojnë vlerësimin përmbledhës para nxënësve, prindërve dhe të akterëve të tjerë;